



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2016

**“PËR MIRATIMIN E KATEGORIVE, KUSHTEVE, KËRKESAVE TË
KUALIFIKIMIT E TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR PERSONIN
FIZIK OSE JURIDIK, TË CILIT I LËSHOHET LICENCA E AUDITUESIT
ENERGJETIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për Eficiência e Energjisë”, të ligjit 116/2016, date 10.11.2016, “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”, ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për licencimin e audituesit të energjisë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi
2. Ngarkohen Ministria përgjegjëse për energjinë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË
DAMIAN GJIKNURI

RREGULLORE PËR KATEGORITE, KUSHTET, KËRKESAT E KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR PËR LICENCIMIN E AUDITUESIT TË ENERGJISE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit.

Kjo rregullore ka për objekt dhe shtrin fushën e veprimit në:

1. Kriteret e kualifikimit, organizimin dhe funksionimin e strukturave që kryejnë dhe mbështesin procesin e edukimit dhe të testimit profesional për individë që kërkojnë të licencohen në fushën e auditimit të energjisë.
2. Percaktimin e Kategorive të audituesëve të energjisë, kushtet dhe kriteret paraprake të eksperiences profesionale, procedurat dhe kompetencat ligjore që duhen plotësuar për t'u pajisur me licencën profesionale në fushën e auditimit të energjisë.
3. Të drejtat që kanë individët dhe subjektet për t'u pajisur me licencë në fushën e auditimit të energjisë

Neni 2

Përkufizimi i termave

Të gjithë termat e përcaktuara dhe që rrjedhin nga:

1. Ligji 10081/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligji 124/2015 "Për Eficencën e Energjisë",
3. Ligji 116/2016 "Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa",
4. Ligji 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji" dhe,
5. Ligji 138/2013 "Per Burimet e Rinovueshme" i ndryshuar,

se bashku me ndryshimet e ardhshme që mund të pësojnë keto ligje, kanë dhe do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore, ndërsa me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

"Licencë për auditimin e energjisë", është dokumenti me të cilin pajiset çdo individ vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrojë profesionin e audituesit të energjisë në ndërtesa, procese energjetike dhe në transport. Licenca për auditimin e energjisë është pjesë e aktit administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë veprimtarinë në fushën e auditimit të energjisë.

"Vite eksperiencë" janë vite pune gjithsej të dokumentuara me librezë pune dhe/ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të, nga momenti i diplomimit të nivelit master shkencor.

"Eksperiencë profesionale" është veprimtaria profesionale në fushën e auditimit të energjisë për ndërtesat, proceset energjetike dhe transport e dokumentuar nga ente publike apo private.

“Subjekt” - çdo individ apo person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar (pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit), sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e auditimit të energjisë.

“Diplomë” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë.

“Kategorite e licencimit” janë specifikimi i veprimtarisë në fushën e auditimit të energjisë. Në këtë rregullore janë tre nenkategoritë të licencimit në fushën e auditimit të energjisë: (i) në ndertesa, (ii) në procese energjetike dhe (iii) në transport.

“Kushte të licencimit” janë ato kushte, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave nga titullari i licencës është e detyrueshme.

“Kritere të posaçme të licencimit” është ajo pjesë e kushteve, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës.

“Subjekt”, në kuptim të kësaj rregullore është çdo individ që ushtron veprimtari në fushën e e auditimit të energjisë.

“Sekretariati teknik i Komisionit” është struktura përkatëse pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë që kryen procedurat administrative të vlerësimit, relatimit dhe regjistrimit të individëve që i nënshtrohen testit për auditimin e energjisë.

“Komision i posaçëm”, struktura e posaçme administrative, që krijohet për testimin e audituesve të energjisë dhe asistohet nga stafi përgjegjës për testimin, në Agjencinë e Eficencës së Energjisë. Komisioni ka autoritetin e vetëm për dhënien apo heqjen e licencave për subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e auditimit energjetik.

“Sekretariati teknik”, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe/ose Agjencisë për Eficencën e Energjisë që kryen procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit paraprak të procesit të testimit, relatimit dhe regjistrimit të individëve apo subjekteve që do të ushtrojnë veprimtarinë profesionale në fushën e auditimit të energjisë.

“Grup ekspertësh”, ekspertë të jashtëm (jo më pak se 3), auditues energjie për kategorinë përkatëse, me eksperiencë jo më pak se 10 vjet në fushën e energjisë, të cilët thirren për të shqyrtuar dhe dhënë mendim për çështje të caktuara.

KREU II

KATEGORITË PËR LICENCAT E AUDITIMIT TË ENERGJISË

Neni 3

Licencimi pranë Qendres Kombetare të Biznesit (dega e QKL)

1. Çdo individ apo subjekt, vendas ose i huaj për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e auditimit të energjisë, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (pranë degës së QKL) për t'u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.
2. Kushtet dhe kriteret specifike të cilat kërkohen në përgjithësi për të fituar kategoritë e veprimtarisë në fushën e auditimit të energjisë, jepen në vijim të kësaj rregullore.

3. QKL lëshon licencat për kategoritë e audituesit të energjisë për ndërtesat, proceset dhe transportin, të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4

Kategoritë e Licencave të audituesve të energjisë.

Në Aneksin 1 të VKM nr.538 datë 26/05/2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta“ bëhen shtesat e nënkategorive si më poshtë:

1. Nënkategoria IV.4 Ç “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në ndërtesa”
2. Nënkategoria IV.4 D “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në procese”
3. Nënkategoria IV.4 DH “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në transport”

Në kuptimin e Nenit 19 të ligjit 10081, licencimi i nënkategorive IV.4 Ç, IV.4 D, dhe IV.4 DH bëhet sipas procedurës së grupit të tretë.

Neni 5

Kërkesat e kualifikimit për nënkategoritë e Licencave të audituesit të energjisë

- A. Tre janë nënkategoritë e licencave profesionale në fushën e auditimit të energjisë me të cilat pajiset audituesi i energjisë, të cilat janë si më poshtë:

1. **Nënkategoria IV.4 Ç** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në ndërtesa”:

- a) Duhet të ketë Diplomë në nivelin master i shkencave ose master profesional në arsimin e lartë në shkencat
 - i. Mekanike
 - ii. Elektrike,
 - iii. Ndërtim,
 - iv. Mjedis (drejtimi energjitik),
 - v. Arkitekture.

Të lëshuar pranë institucioneve të arsimit të lartë apo të ketë njehsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.

- b) Të ketë të paktën 5 vite eksperience në fushën e energjisë, në institucione publike në fushën e energjisë, shoqëri studimi e projektimi, ose institucionet e arsimit të lartë sipas degëve të mësipërme.
- c) të disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë për ndërtesat, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, ose ka kryer njohjen zyrtare të certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.

- d) Të disponojë certifikatë për kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë të lëshuar nga Agjensia e Eficencës së Energjisë, ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për energjinë.
2. **Nenkatëgoria IV.4 D** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në procese”;
- a) Duhet të këtë Diplomë në nivelin master i shkencave ose master profesional në arsimin e lartë në shkencat:
- i. Mekanike
 - ii. Elektrike,
 - iii. Mjedis (drejtimi energjitik),
- të lëshuar pranë institucioneve të arsimit të lartë apo të ketë njëhsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
- b) Të ketë të paktën 10 vite eksperience në fushën e energjisë, në institucione publike në fushën e energjisë, shoqëri studimi e projektimi, ose institucionet e arsimit të lartë sipas degëve të mësipërme.
- c) të disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë për proceset, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, ose ka kryer njohjen zyrtare të certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
- d) Të disponojë certifikatë për kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë të lëshuar nga Agjensia e Eficencës së Energjisë, ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për energjinë.
3. **Nenkatëgoria IV.4 DH** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjitik në transport”
- a) Diplomë në nivelin master shkencor në arsimin e lartë në shkencat
- i. Mekanike
 - ii. Elektrike,
 - iii. Mjedis (drejtimi energjitik),
 - iv. Urbanistike
- të lëshuar pranë institucioneve të arsimit të lartë apo të ketë njëhsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.
- b) Të ketë të paktën 7 vite eksperience në fushën e transportit, në institucione publike në fushën e transportit ose energjisë, shoqëri të transportit publik, urban, interurban ose ndërkombëtar, si dhe të mallrave, shoqëri studimi e projektimi në fushën e transportit, ose institucionet e arsimit të lartë në shkencat për transportin.
- c) të disponojë certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë për transportin, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, ose ka kryer njohjen zyrtare të certifikatave, të lëshuara nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin.

- d) Të disponojë certifikatë për kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë të lëshuar nga Agjensia e Eficencës së Energjisë, ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për energjinë.

Kushtet e mësipërme, vlejnë dhe për individët e huaj që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale në fushën e auditimit të energjisë, nëse dokumentet e paraqitura janë të ekuivalentuara nga autoritetet përgjegjëse dhe të njohura sipas legjislacionit në fuqi.

- B. Një individ mund të jetë zotëruar i më shumë se një kategorie të licencës profesionale të audituesit të energjisë ose të ketë të përshkruara në licencën profesionale të tij disa nga kategoritë e shkronjave Ç, D dhe DH, të përmendura më sipër.
- C. Kur një person humbet licencën profesionale të auditimit të energjisë, njofton menjëherë zyrtarisht në QKL. Subjekti pajiset me dublikatë, në bazë të kërkesës së tij të shoqëruar me fotokopjen e kartës së identitetit dhe diplomës, pas verifikimit të kopjes origjinale të licences dhe kategorive përkatëse të auditimit të energjisë të depozituar në zyrën e protokollit QKB.
- D. Elementet e licencës profesionale për veprimtarinë e auditimit energjetik janë:
 - a) Numri i regjistrimit themeltar dhe data;
 - b) Të dhënat personale të subjektit (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendbanim dhe fotografi);
 - c) Data dhe titulli i diplomimit universitar dhe/ose pasuniversitar;
 - d) Kategorinë e licencës.
- E. Licenca për individët është e përhershme. Licenca nuk lejohet të shitet, të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një individ tek një tjetër.
- F. Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe nënshkrimi i përkthyesit të jetë i konfirmuar nga noteri.

Neni 6

Ekivalentimi i licencës profesionale të audituesit të energjisë për individë që disponojnë licencë profesionale të ngjashme në vendin e origjinës (jo Shqipëri)

Aplikimi për ekuivalentimin e licencës profesionale të auditimit të energjisë individuale për individët kanë përfituar këtë licence në vende të huaja, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake, të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- a) kërkesën e individit, ku të përcaktohen, të paktën, gjeneralitetet, adresa e plotë e individit, fusha dhe shkalla që mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;
- b) dokumentin e identitetit që disponon;
- c) dy fotografi 3x4 cm të vlerësuesit;
- d) diplomën që disponon në vendin e origjinës, të legalizuar, sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- e) certifikatën për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar për auditimin e energjisë, për kategorinë/të ku kërkon të licencohet, të lëshuar në vendin e origjinës, të legalizuar sipas dispozitave në fuqi dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- f) licencën e audituesit të energjisë që disponon në vendin e origjinës, të legalizuar sipas dispozitave në fuqi dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;

- g) listën e objekteve të audituara;
- h) referenca nga subjekte të ndryshme, në lidhje me veprimtarinë e ushtruar në fushën e auditimit të energjise (të përkthyer);
- i) kopje të raporteve të auditimit, të përkthyer në gjuhën shqipe, nga të cilat të jenë hequr të gjitha elementet që përfshijnë të dhëna konfidenciale apo të dhëna të tjera, që përbëjnë shkelje të kontratave apo kodeve të etikës (jo më pak se 3 raporte në vit, për të paktën 2 vjet eksperience, dhe në lidhje me kategorine/të për të cilat kërkohet licencën e ekuivalentuar), në rastin kur kërkohet të ekuivalentohet licenca sipas tre kategorive;
- j) vetë deklaram, ku individ të deklarojë se njih dhe angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e auditimit të energjisë dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojë se nuk është i dënuar nga organet e gjyqësorit, në lidhje me ushtrimin e profesionit të auditit në vendin e origjines;
- k) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale.

KREU III

PROGRAMET E STUDIMIT TË VAZHDUAR PASUNIVERSITAR PËR PËRGATITJEN PROFESIONALE TË AUDITUESVE TË ENERGJISË. ÇERTIFIKATA E AUDITUESIT.

Neni 7

Kriteret e formimit të vazhduar pasuniversitar për audituesit e energjisë.

- I. Me qëllim unifikimin e dijeve të audituesve të energjisë me prejardhje të ndryshme të formimit universitar këta të fundit duhet të ndjekin programe studimi në varësi të kriterëve me karakter profesional të parashikuara në këtë rregullore dhe me programe të formimit të vazhduar në fushat ku ato plotësojnë keto kriterë. Programet e studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë duhet të jenë në përputhje me ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- II. Tematikat minimale udhëzuese për të cilat kërkohet të kenë formim aplikantët për licencën profesionale në fushën e auditimit energjetik janë:

A. Tema të përbashkëta

- 1. Legjislacioni për eficienten e energjisë.
- 2. Përgatitja për auditimin e energjisë.
 - a. Përcaktimi i qëllimit të auditit.
 - b. Krijimi i një plani të auditit.
 - c. Përgatitja e listës për tu audituar.
 - d. Kqyrja dhe studimi paraprak i objektit.
 - e. Mbledhja e faturave të energjisë.
 - f. Analiza paraprake energjetike.
 - g. Bilanci fillestar i energjise.
- 3. Analiza e faturave të energjisë.
 - a. Faturat e energjisë elektrike.
 - b. Faturat e gazit.
 - c. Faturat e naftës.

- d. Faturat e cdo lënde djegëse tjetër.
- e. Analiza grafike e konsumit historik.
4. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.
 - a. Inventari i ngarkesës energjetike.
 - b. Percaktimi i flukseve (rrymave) të energjisë.
 - c. Matja e ngarkesave në mororrat elektrike
5. Analiza e Kost-Benefitit për masat e eficientës.
 - a. Analiza LCCA (Life-cycle cost analysis)
 - b. Metoda LCC (Life cycle cost).
 - c. Metoda NPV (Net present value).
 - d. Metoda IRR (Internal rate of return).
 - e. Periudha e vetshlyerjes SPP (Simple payback period).
6. Hartimi i raportit të auditimit dhe potencialet e mundshme të kursimit.
7. Hartimi i një plani veprimi për zbatimin e masave të eficientës.
8. Deklarimi i kusimeve të energjisë në raport me ndikimet në mjedis - analiza CO2
9. Analiza teknike-ekonomike e investimeve për masat e parashikuara.
10. Njohja e burimeve energjetike dhe transformimi i tyre
 - a. Impiantet termike, makina termike.
 - b. Impiante të transformimeve në procese energjetike.
 - c. Impiante ftohëse.
11. Bazat energjetike dhe performanca e energjisë në teknologjitë tradicionale dhe inovative;
12. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik:
 - a. Sistemeve teknike të reja;
 - b. Sistemeve teknike të ekzistuese
13. Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike
14. Qëllimi i auditimit dhe shembuj praktikë
15. Menaxhim energjie; zhvillimi i kërkesave për përmirësimin/zëvendësimin e pajisjeve me konsum të pa justifikuar të energjisë në raport me eficientën
16. Skenaret energjetike dhe bilancet energjetike; Analiza tekniko ekonomike e ndërhyrjeve dhe vlerësimi i potencialeve të kursimit të energjisë
17. Energjia dhe transformimet e saj. Rekomandime për ndërhyrjet energjetike. Kostot optimale të ndërhyrjeve
18. Eficienta e energjisë dhe mbrojtja e mjedisit.

B. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në NDËRTESA

1. Legjislacioni për performancën e energjisë në ndërtesa.
2. Procedurat për certifikimin energjetik të ndërtesave.
3. Standartet dhe rregulloret teknike në fushën e konsumit të energjisë në ndërtesa.
4. Detyrimet dhe përgjegjësitë e certifikuesit.
5. Sistemet teknike të ndërtesave rezidenciale (Ngrohja, Ventilimi, Kondicionimi, Ndriçimi, Uji ngrohte, Gatimi, Larja)
6. Bilanci i energjisë i sistemit të ndërtimit. Auditimi i konsumit dhe analiza energjetike
7. Llogaritja e performancës energjetike të ndërtesave dhe metodologjia.
8. Analiza e ndjeshmërisë për variablat kryesorë që të ndikojë në kostot energjetike.
9. Analiza teknike-ekonomike e investimeve në ndërtesë
10. Njohja e burimeve energjetike dhe transformimi i tyre në ndërtesë
11. Ushtrime praktikë me vëmendje të veçantë ndaj ndërtesave ekzistuese.
12. Mbeshtjella izoluese e Ndërtimit:

13. Llojet dhe performanca e energjisë e elementëve të ndertimit;
14. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik:
 - a. e ndërtesave të reja;
 - b. përmirësimi i ndërtesave ekzistuese.
15. Impiantet termike;
16. Bazat energjetike dhe performanca e energjisë në teknologjitë tradicionale dhe inovative;
17. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik;
18. Sistemeve teknike të reja;
19. Sistemeve teknike të ekzistuese.
20. Adopimet për të rinovuar teknologjitë në ndërtesa
21. Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike të ndërtesës
22. Komforti termik në ndërtesë.
23. Ventilimi natyral dhe mekanik. Rekuperatorët e energjisë
24. Risi teknologjike për menaxhimin e ndërtesës dhe sistemeve teknike të saj.
25. Njohja e fushëveprimit të konsumit të energjisë në sistemet Rezidenciale dhe Shërbimet
26. Auditimi i energjisë të ndërtesave. Kriteret e auditimit dhe kërkesat me të domosdoshme për auditim
27. Qëllimi i auditimit dhe shembuj praktikë
28. Përdorimi praktik i instrumentave matës të nevojshëm për të marrë të dhëna reale për procese të inspektimit dhe auditimit.
29. Konsumi i energjisë në banesë dhe bilanci auditues
30. Eficenca e energjisë në pajisjet elektrike.
31. Eficenca e sistemeve të pompimit dhe përpilimi i raportit të auditimit.
32. Eficenca e energjisë dhe mbrojtja e mjedisit.
33. Analiza tekniko ekonomike e nderhyrjeve në respekt të mjedisit.

C. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në PROCESË ENERGETIKE

1. Eficenca e energjisë në pajisje dhe sisteme utilitare kryesisht në Industri. Njohuri të mjaftueshme në konsumin e energjisë në sistemet industriale.
2. Raporti i auditimit dhe potencialet e efencës së energjisë në Industri
3. Përpilimi i një raporti auditimi në ndërmarjen industriale
4. Rekuperuesit e energjisë në kaldaja.
5. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.
 - a. Inventari i ngarkesës elektrike
 - b. Inventari i përdorimit të energjisë termike
 - c. Kërkesa specifike sipas sistemeve
 - d. Balanca e energjisë
6. Analiza e përdorimit të energjisë dhe skemat e prodhimit.
 - a. Profili i Ngarkesës/Kërkesës
 - b. Skemat e dinamikës së prodhimit të energjisë
 - c. Interpretimi i skemave të prodhimit të energjisë.
7. Identifikimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe të reduktimit të kostove.
 - a. Kontrolli i kërkesës për energji elektrike
 - b. Masa të kursimit të energjisë sipas sistemeve.
 - i. Mundësi të kursimit të energjisë në Motorët elektrikë.
 - ii. Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e Ajrit të Kompresuar

- iii. Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Pompimit
- iv. Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Ventilimit
- v. Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Ndricimit
- vi. Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet me Avull.
- vii. Mundësi të kursimit të energjisë në Proceset e Ngrohjes.
- c. Mundësi të kursimeve të energjisë sipas sektorëve specifik.
- 8. Instrumentat e Auditimit të Energjisë në Industri.
 - a. Cështjet e sigurisë gjatë auditimit
 - b. Matësit e parametrave elektrikë
 - c. Matësit e temperaturës
 - d. Matësit e rrjedhës në tuba
 - e. Matësit e gazeve të cliruar
 - f. Matësit e shpejtësisë së rrotullimit
- 9. Njohja e proceseve të përpunimit të lëndëve të para të ndërtimit dhe nevoja për energji të sistemeve industriale të prodhimit
 - a. Mundësi të kursimit të energjisë në industri specifike
 - b. Industria e Cimentos
 - c. Industria e Hekurit dhe Celikut
 - d. Industria Tekstile
 - e. Industria e Kimike e Naftës dhe Nënprodukteve
 - f. Industria e Qelqit
 - g. Industria e përpunimit të Frutave dhe Perimeve.
 - h. Sistemet e përpunimit dhe trajtimit të ujrave urbane

D. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në TRANSPORT

1. Deklarimi i kusimeve të energjisë në raport me ndikimet në mjedis nëpërmjet CO₂
2. Planifikimi dhe logjistika e intinerareve të udhëtimit.
 - a. Optimizimi i udhëtimit duke marrë parasysh relievin.
3. Elementet që krijojnë resistencë aerodinamike
4. Transmetimi i energjisë në tokë, Resistenca e rrotullimit të gomave
5. Zinxhiri i konvertimit të energjisë.
 - a. Proceset e Djegies në motora / Humbjet në konvertimin e Energjisë.
6. Kushtet atmosferike dhe ndikimi i tyre në efincën në transport
7. Mjetet më të përdorura të transportit
 - a. Inspektimi i Veturave, Furgonave, Kamionave Autobusave, Individualisht dhe parkun e automjeteve në tërësi.
 - b. Mirëmbajtja në kushte optimale të efincës të mjeteve
 - c. Analiza ekonomike e rinovimit të flotës së automjeteve
8. Ndikimi i faktorit njerëzor në efincën e energjisë.
 - a. Praktikrat ideale të përdorimit të mjeteve në lidhje me kursimin e energjisë.
9. Zhvillimi i teknologjisë në transport.
 - a. Mjetet Hibride dhe llojet e ndryshme të tyre
 - b. Mjetet elektrike dhe potenciali i tyre.
10. Treguesit e performancës së energjisë në transport , Psh:
 - a. Energjia e konsumuar/Distancën
 - b. Energjia e konsumuar /(Distanca * Numri i pasagjerëve)
11. Standartet në auditimin e energjisë.
12. Mbledhja e të dhënave në terren.

III. Programet e studimit të vazhduar pasuniversitar mund të trajtojnë dhe zhvillojnë në programet e tyre të mësimdhënies temat udhëzuese të përfshira në piken II te ketij neni.

- IV. Temat udhëzuese të përfshira në piken II të këtij neni do të jenë referencat mbi të cilat do të bazohen pyetjet e testimit.
- V. Komisioni i testimit, nëpërmjet testit, verifikon njohuritë e aplikuesve me temat udhëzuese të përfshira në piken II të këtij neni, dhe njohuritë mbi legjislacionin primar, sekondar dhe terciar në fushën e Eficencës së Energjisë dhe Energjinë e Rinovueshme. Legjislacioni primar përfshin:
- A. Ligjin 124/2015 “Për Eficencën e Energjisë” me ndryshimet e ardhshme,
 - B. Ligjin 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndertesa” me ndryshimet e ardhshme
 - C. Ligjin 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” me ndryshimet e ardhshme,
 - D. Ligjin 138/2013 “Për Burimet e Rinovueshme” i ndryshuar dhe me ndryshimet e ardhshme,
- Legjislacioni sekondar përmban të gjitha VKM-te që rrjedhin nga legjislacioni primar. Legjislacioni terciar përmban të gjitha rregulloret, metodologjitë apo udhëzimet që rrjedhin nga legjislacioni primar dhe sekondar.
- VI. Programet e studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë duhet të zhvillohen në të paktën 100 orë mësimi, nga të cilat minimalisht 80 orë janë leksione dhe 20 orë laborator ose mesime mësimi praktike në kantjer. Programi duhet të përfundojë me 20 kredite të vleresuara.

Neni 8

Testimi i detyrueshëm për audituesit e energjisë

Me qëllim kontrollin e njohurive të aplikantëve që aplikojnë për tu pajisur me licencën e auditimit të energjisë dhe për të garantuar se njohuritë dhe kompetencat e fituara nëpërmjet shkollimit dhe trajnimit të vazhduar pasuniversitar janë të njëjta ndërjet aplikantëve, këta të fundit i nënshtrohen një Testimi.

1. Testimi për auditimin e energjisë zhvillohet nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për Energjinë.
2. Testimi është kusht i detyrueshëm për tu pajisur me licencën e audituesit të energjisë.
3. Procesi i kryerjes së testimit zhvillohet nga Komisioni i posaçëm pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë ose, deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për Energjinë. Cdo individ që aplikon pranë Qendres Kombëtare të Biznesit (QKB) për licence profesionale për kategorinë e auditimit të energjisë pranë Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) në QKB, duhet të disponojë një certifikatë për kryerjen e programeve të studimit të vazhduar pasuniversitar, për auditimin e energjisë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, për kryerjen e këtyre programeve.
4. Agjencia e Eficencës së Energjisë ose, deri në krijimin e saj, Ministria përgjegjëse për Energjinë akrediton nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, njohjen zyrtare të certifikatave, deshmive apo licencave standarde të lëshuara nga institucionet e huaja, duke vertetuar se aplikanti ka kryer testimin e domosdoshëm në fushën e auditimit të energjisë. Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti bëhet testimi në fushat

për të cilat aplikanti nuk është në gjendje të paraqese dokumentacionin. Një Komision i Posaçëm bën vlerësimin dhe merr një vendim rast pas rasti.

Neni 9

Krijimi, përbërja, veprimtaria dhe vendimarrja e Komisionit të Posaçëm për testimin e audituesve të energjisë.

1. Komisioni i posaçëm për testimin e audituesve të energjisë ushtron veprimtari në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënljgore në fuqi, që përcaktojnë kritere në këtë fushë.
2. Kryetari i Komisionit është drejtori i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, ose/dhe deri në krijimin e saj, një nga zëvendës Ministrat e Ministrisë ose Sekretari i Përgjithshëm përgjegjës për Energjinë. 7 anëtarët e tij propozohen nga Kryetari ose, deri në krijimin e Agjencisë, nga zv. Ministri përgjegjës për Energjinë. Komisioni miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë dhe në përbërje të tij, si rregull, ka:
 - i. një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për energjinë
 - ii. dy përfaqësues nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë;
 - iii. një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për zhvillimit urban kur testohet nenkategoria e audituesit në fushën e ndërtesave, ose një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për transportin kur testohet kategoria e audituesve në fushën e transportitnjë përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (ose Arkitektures);
 - iv. një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - v. një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - vi. një përfaqësues nga sekretariati teknik i Komisionit pa të drejtë vote.
3. Anëtarët e komisionit të posaçëm mund të jenë punonjës të Agjencisë së Efiçencës së Energjisë ose Ministrisë përgjegjëse për Energjinë në qoftë se anëtari nga jashtë sistemit të Ministrisë përgjegjëse për energjinë nuk paraqitet në Komision. Kryetari në mungesë të kuorumit (50%) cakton deri në 2 anëtarë të rinj pa miratim të mëtejshëm. Në çdo rast anëtari i komisionit i emeruar sipas kësaj pike duhet të këtë licence të audituesit të energjisë sipas kategorive në shqyrtim dhe kërkesave të ligjit 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa” dhe nuk ka të drejtë të ushtrojë licencën jashtë institucioneve të sistemit të energjisë.
4. Komisioni merr vendime për fondin e pyetjeve, vlerësimin e kandidatëve, procesin e kryerjes së testimit dhe lëshimin e certifikatave të testimit.
5. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij, mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“
6. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll. Protokollin mbahet nga një përfaqësues i Sekretariatit teknik të Komisionit. Protokollin përmban të dhëna, të paktën për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve.
7. Kryetari i Komisionit vendos për praktikën e përgatitura nga Sekretariati Teknik që lidhen me kërkesa të individëve në lidhje me testin e auditit të energjisë të karakterit formal.
8. Vendimet në Komision si rregull merren me konsensus; kur ky nuk arrihet merret me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës. Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.

9. Vendimet e Komisionit hartohen nën përgjegjësinë e Sekretariatit Teknik, dhe nënshkruhen nga Kryetari dhe anëtarët e Komisionit që kanë qënë pjesëmarrës në mbledhje. Vendimet e Komisionit përgatiten në tre kopje: njëra dorëzohet në zyrën e arkiv dokumentacionit, tjetra në Sekretariatit teknik, për veprime të mëtejshme dhe e treta në praktikën e Komisionit që disponohet nga Kryetari i Komisionit.

Neni 10

Sekretariati teknik dhe përgatitja e materialeve për Komision

1. Sekretariati Teknik i Komisionit është organizuar dhe funksionon pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë ose, deri në krijimin e saj, në Ministrinë përgjegjëse për Energjinë.
2. Organizimi i Sekretariatit bëhet në bazë e zbatim të strukturës organizative të Agjencisë së Eficencës së Energjisë ose/dhe, deri në krijimin e saj, në Ministrinë përgjegjëse për Energjinë.
3. Veprimtaria e Sekretariatit zhvillohet në përputhje me rregulloren e brëndshme të Agjencisë së Eficencës së Energjisë ose/dhe, deri në krijimin e saj, të Ministrisë përgjegjëse për Energjinë dhe sipas kësaj rregullore.
4. Anëtarët e sekretariatit teknik caktohen me urdhër të drejtorit të Agjencisë së eficencës ose deri në krijimin e saj nga zv. Ministri i Energjisë.
5. Rendi i ditës për mbledhjen e rradhës të Komisionit hartohet nga Sekretariati teknik dhe miratohet nga Kryetari i Komisionit jo më vonë se tre ditë nga mbledhja e rradhës së Komisionit. Sekretariati caktohet me udhër të Drejtorit të Agjencisë për Efiçencën e energjisë ose, deri në themelimin e saj nga zv. Ministri përgjegjës për energjinë.
6. Komisioni shqyrton materiale që kanë të bëjnë me testimin e individëve, ankesa të tyre për vendimet pararendëse, informacione e kërkesa të enteve publike apo private, përfundime dhe raporte nga kontrollet e kryera.
7. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati teknik jo më vonë se tre ditë para ditës së caktuar për mbledhje.
8. Materialet përgatiten nga Sekretariati teknik dhe nënshkruhen edhe nga zyrtari respektiv dhe/ose përpunuesit e tij.

Neni 11

Aplikimi për testimin e audituesve të energjisë

1. Aplikuesit për testin e audituesit të energjisë paraqiten pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë ose, deri në krijimin e saj, në Ministrinë përgjegjëse për Energjinë për të bërë regjistrimin. Regjistrimi kryhet duke plotësuar formularin përkatës për aplikim.
2. Format i formularit të aplikimit hartohet nga Komisioni në mbledhjen e tij të parë dhe miratohet nga Drejtori i Agjencisë ose deri në emërimin e tij nga Ministri. Në formularin e aplikimit plotësohen të dhënat personale të aplikuesit dhe të dhënat mbi shkollimin dhe trajnimet përkatëse. Formulari i aplikimit shoqërohet me fotokopje të dokumentit të identifikimit, të diplomave dhe certifikatave që vërtetojnë kualifikimet. Dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer nga përkthyes të licencuar në gjuhën shqipe.

3. Aplikimet regjistrohen në protokollin e posaçëm të Agjencisë për Efiçencën e Energjisë ose, deri në krijimin e saj, prane protokollit të Ministrisë përgjegjëse të energjisë, të shoqëruara me kartelë. Në kartelën shoqëruese evidentohen shënime në lidhje me përputhshmërinë e dokumentacionit të aplikimit me kërkesat e kësaj rregullore. Kartela nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës i Sekretariatit Teknik që trajton aplikimin dhe që jep mendim për kërkesën deri në vendimin e Komisionit. Mendimi i zyrtarit reflektohet detyrimisht në materialin që i paraqitet Komisionit dhe bazohet në këtë kartelë.
4. Sekretariati përpilon listën me kërkesat për test bazuar në Fondin e pyetjeve për secilën kategori dhe e paraqet tek Kryetari i Komisionit dy dite para testimit. Komisioni vlerëson përpunueshmërinë e kritereve të aplikantëve dhe miraton listën e pjesëmarrësve deri në 5 ditë pune përpara datës së zhvillimit të testit. Afati i fundit për plotësimin e formularit të aplikimit është 10 ditë pune nga data e vendosur për zhvillimin e testit.

Neni 12

Fondi i pyetjeve dhe Zhvillimi i testit të audituesve të energjisë

1. Agjencia për Efiçencën e Energjisë ose, deri në krijimin e saj, Ministria përgjegjëse për Energjinë krijon fondin e pyetjeve për testet që do të zhvillojë për audituesit e energjisë. Për krijimin e fondit të pyetjeve ngarkohen anëtarët e komisionit, ose me vendim të komisionit, sipas legjislacionit në fuqi, kontraktohen ekspertë të jashtëm.
2. Fondi i pyetjeve përbëhet nga 250 pyetje në momentin e krijimit. Fondi pyetjeve përditësohet çdo 6 muaj nga grupi i punës me të paktën 30 pyetje reja. Pyetjet e reja i shtohen fondit të pyetjeve ekzistues. Fondi i pyetjeve përbëhet nga pyetje me alternativa dhe/ose shtjellim. Fondi i pyetjeve ndahet në dy pjesë: (i) Pyetjet e formimit të përgjithshëm, të cilat janë të njëjta për të tre llojet e kategorive të audituesve; (ii) Pyetjet specifike sipas kategorisë përkatëse të auditimit të energjisë.
3. Testet për auditimin e energjisë zhvillohen çdo 3 muaj. Komisioni vendos për datën e testit jo më vonë se 14 ditë kalendrike përpara datës së vendosur për zhvillimin e tij. Data e testit u lajmërohet aplikuesve që kanë plotësuar formularin e aplikimit si dhe publikohet online, jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara datës së vendosur të testit. Numri i pjesëmarrësve në test mund të limitohet në vartësi nga numri i aplikuesve dhe nga mundësitë teknike të Agjencisë ose Ministrisë për të zhvilluar testin. Nëse numri i aplikuesve për test është më i madh se sa kapacitet teknike, testi zhvillohet në 2 ditë të njëpasnjëshme, jo më shumë se një herë në tre muaj.
4. Katër orë para testit, anëtarët e komisionit përzgjedhin, secili në mënyrë rastësore, të paktën 20 pyetjet që mund të jenë pjesë e testit. Sekretari i komisionit përjashton pyetjet e perseritura dhe printon testet sipas numrit të aplikantëve duke bërë ndryshime në disa teza të testeve, që kryesisht lidhen me përzgjedhjen rastësore të antareve të komisionit. Testi ose testet do të jenë në formë të shkruar dhe përbëhen nga 100 pikë, të shpërndara në jo më pak se 33 pyetje. Kohëzgjatja e testimit është jo më shumë se 2 orë e 30 minuta. Sekretari verifikon identitetin e pjesëmarrësve në test nëpërmjet Kartës së Identitetit ose Pasaportës. Gjatë testimit nuk lejohet komunikimi i asnjë forme, përveçse me anëtarët e komisionit. Pas mbarimit të testimit, komisioni korrigjon fletët e testit dhe mban shënime pikët për çdo aplikant.
5. Një aplikant shpallet kalues kur merr të paktën 60 pikë nga totali i mundshëm. Pas korrigjimit, hartohet një procesverbal i firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit në të cilin

deklarohen në formë tabelore emrat e aplikuesve, pikët përkatëse dhe shpalljen fitues ose jo. Sekretari duke iu referuar procesverbalit të miratuar nga Komisioni për testin përkatës përpilon certifikatën për pjesmarrësit kalues. Të gjithë pjesmarrësit lajmërohen nëpërmjet postes elektronike për rezultatet e testimit. Të dhënat për rezultatet e pjesmarrësve të testit ruhen në formë elektronike.

Neni 13

Certifikata, protokoli, regjistrat dhe arkivimi për testin e audituesit të energjisë.

1. Komisioni miraton formatin e certifikatës së testit të auditit të energjisë, e cila duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:
 - a. Emërtimi dhe stema e institucionit që lëshon certifikatën
 - b. Të dhënat për identifikimin e subjektit që do të disponojë certifikatën
 - c. Kategorinë e kërkuar të testimit të njohurive dhe pikët e testimit
 - d. Emrin e kryetarit të komisionit, nënshkrimin e tij dhe vulën përkatëse
 - e. Numrin e regjistrimit për testimin.
2. Certifikata për individët është e përhershme. Ajo nuk lejohet të shitet, të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një individ tek një tjetër. Certifikatat hartohen dhe kompletohen në të gjitha elementët e tyre, brenda 10 ditëve punë, pas nënshkrimit të vendimit për fituesit nga Komisioni, vendim i cili merret jo më vonë se 3 dite pune pas zhvillimit të testimit. Sekretariati teknik, mbi bazën e vendimit të Komisionit, përgatit certifikatat në dy kopje origjinale. Njëra, prej të cilave pas nënshkrimit nga Kryetari, i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra e nënshkruar edhe nga hartuesit dhe anetaret e komisionit, ruhet për arkivim. Sekretariati teknik harton, mban dhe përditëson protokollin, ku evidenton të gjitha kërkesat e individëve për të kryer testin.
3. Certifikatat që vërtetojnë kalimin me sukses të testit janë dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë. Formatit i tyre propozohet nga Komisioni dhe miratohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë.
4. Arkivi i Sekretariatit teknik, sipas mundësive, organizohet bashkë ose veças nga arkivi i Ministrisë, me Urdhër të veçantë të Titullarit. Në Arkiv, arkivohen dokumentat e plota të cdo individi ose subjekti që ka paraqitur kërkesë për tu testuar dhe certifikatën e përfituar prej tij.
5. Sekretariati Teknik përgjigjet për arkivimin sipas rregullores së institucionit, kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për pagesën sipas tarifës 150 lek për pjesëmarrjen në testim të kandidatit.

Neni 14

Ankimi

1. Për çdo vendim të Komisionit, individët, kanë të drejtën e ankimit tek Ministri përgjegjës për energjinë brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit apo publikimit. Ministri mund të delegojë këtë të drejtë tek Sekretari i Përgjithshëm i kesaj ministrie
2. Titullari i Ministrisë pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti vendos, brenda 10 ditëve:
 - a. Lëniën në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni.
 - b. Kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në Komision.
 - c. Anullon vendimin e marrë.